



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër: 01-016/01-40239 , dt. 29 Qershor 2026.

Në bazë të nenit 12.paragrafi 12.2 pik d) dhe nenit 51 paragrafi 51.2. të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 13 paragrafi 1 dhe nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MPL Nr.05/2020 për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komuna, dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 dhe nenit 45 paragrafi 3 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, dt. 30.Shtator 2020, në Rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa, Kuvendi Komunal në takimin e mbajtur me datë: 29 Qershor 2026, merr:

VENDIM

Nr.77/2026

Për themelimin e Komiteteve të Tjera

1. Miratohet Vendimi për themelimin e Komiteteve të Tjera të Kuvendit të Komunës së Pejës.

2. Komitetet të Tjetër, sipas pikës 1 të këtij vendimi, janë:

1. Komiteti për Arsim,
2. Komiteti për Shëndetësi,
3. Komiteti për Persona të Moshuar,
4. Komiteti për Urbanizëm.

3. Përbërja e komitetit të cekur në pikën 2 nën pika 1 të këtij vendimi, është si vijon:

3.1. Komiteti për Arsim:

1. Gentiana Bajrami Atashi, anëtar i kuvendit nga subjekti politikë (LDK), anëtare,
2. Vlora Kuçi, -/- (AAK), anëtare,
3. Hidajete Nikçi, -/- (LVV), anëtare,
4. Përfaqësues jashtë Kuvendit të Komunës – ekspert të fushës, anëtarë,
5. -/- anëtarë.

3.2. Drejtorja e Arsimit, obligohet të bëjë përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit të Arsimit, nga jashtë kuvendit - ekspert të fushës së arsimit.

4. Përbërja e komitetit të cekur në pikën 2 nën pika 2 të këtij vendimi, është si vijon:

4.1. Komiteti për Shëndetësi:

1. Drite Maloku, anëtar i kuvendit nga subjekti politik (LDK), anëtare,
2. Ilirjane Gafuri, -/- (AAK), anëtare,
3. Gemza Sylejmani, -/- (LVV), anëtarë,
4. *Përfaqësues jashtë Kuvendit të Komunës – ekspert të fushës,* anëtarë,
5. - //- anëtarë.

4.2. Drejtorja e Shëndetësisë, obligohet të bëjë përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi, nga jashtë kuvendit - ekspert të fushës së shëndetësisë.

5. Përbërja e komitetit të cekur në pikën 2 nën pika 3 të këtij vendimi, është si vijon:

5.1. Komiteti për Persona të Moshuar:

1. Islam Husaj, anëtar i kuvendit nga subjekti politik (LDK), anëtarë,
2. Shaban Ramaj, -/- (AAK), anëtarë,
3. Leotrim Murtezaj, -/- (PDK), anëtarë,
4. *Përfaqësues jashtë Kuvendit të Komunës – ekspert të fushës,* anëtarë,
5. -/- anëtarë.

5.2. Drejtorja për Mirëqenie Sociale në bashkëpunim me Këshillin Lokal për Moshë të Tretë në Pejë, obligohet të bëjë përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit për Persona të Moshuar, nga jashtë kuvendit - ekspert të fushës apo anëtar të këshillit.

6. Përbërja e komitetit të cekur në pikën 2 nën pika 4 të këtij vendimi, është si vijon:

6.1. Komiteti për Urbanizëm:

1. Nasret Hajrizi, anëtar i kuvendit nga subjekti politik (PDK), anëtare,
2. Muamel Dupljak, -/- (BSK), anëtare,
3. Mirsad Berisha, -/- (PLE), anëtarë,
4. *Përfaqësues jashtë Kuvendit të Komunës – ekspert të fushës,* anëtarë,
5. - //- anëtarë.

5.2. Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, obligohet të bëjë përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit për Persona të Moshuar, nga jashtë kuvendit - ekspert të fushës.

7. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komiteti.

8. Anëtarët e komiteteve tjera për punën e tyre kompensohen nga buxheti i komunës. Paguhet për 6 (gjashtë) mbledhje të cilat mbahen brenda një viti, në proporcion me shumën e mjeteve që kompensohen anëtarët e komiteteve obligative.

9. Mandati i Komiteteve tjera është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.

10. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlejnjë Vendimet për themelimin e komiteteve tjera, themeluar nga përbërja e kaluar e kuvendit.

11. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përkatëse për qeverisje lokale, si dhe 7 (shtat) ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

MAPL,

Kryetarit të Komunës,

Drejtorisë për Arsim,

Drejtorisë për Shëndetësi,

Këshillit Lokal për Moshën Tretë,

Arkivë.



KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj